



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 983 Prot.

Gjirokastër, më: 18/06/2024.

VENDIM
Nr. 13. Dt. 18.06.2024

Bazuar në nenin 6, pika 2, gërma a, b dhe e të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër", KIZ

VENDOSI:

- Të miratojë 3 Qendra Votimi ku do të votohet nga Personeli Akademik dhe Studentët, në tre Njësitë Kryesore të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër", më 21.06.2024, si më poshtë:
 - KFZ e FESHSH-së operon në Qendrën e votimit Nr.1, me vendndodhje në hollin e katit të parë në godinën B.
 - KFZ e FSHN-së operon në Qendrën e votimit Nr.2, me vendndodhje në hollin e katit të parë në godinën A.
 - KFZ e FE-së operon në Qendrën e votimit Nr.3, me vendndodhje në hollin e katit të dytë në godinën B.
 - KZF-të përkatëse kryejnë funksionet e Komisionit të Qendrës së Votimit.
- Në mbyllje të procesit të votimit, Komisionet e Qendrës së Votimit të përdorin 5 kutitë e votimit të Trupës zgjedhore "Personel Akademik" si kutitë respektive të materialeve zgjedhore. Këto kuti do të vulosen me të njëjtat vula sigurise që u përdoren për mbylljen e kutive në hapjen e procesit të votimit, në orën 08:00.
- Nëse rezultojnë fletë votimit të hedhura në kutitë e gabuara, këto fletë votimi të konsiderohen fletë votimi të pavlefshme dhe të pasqyrohen në "Procesverbalin e fletëve të votimit të hedhura në kutinë e gabuar". Procesverbali në fjalë të firmoset nga të gjithë anëtarët e KZF-së dhe të shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZF-së përkatëse.

Ky vendim publikohet dhe Ju përcillet KZF-ve përkatëse.

KRYETARI

(Emër Mbiemër Firma)

Zamira Boboli

ANËTAR

(Emër, Mbiemër Firma)

B. Tula Anulij

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Blertha Korre

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Dhori Terzo

ANËTAR

(Emër Mbiemër Firma)

Audul Alikaj

